

3.6 HIDROIZOLUES PËR BETONIN

IZO CRYSTAL



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
20 kg/thes	54 cp/paletë	2-3 kg/m ²	Gri



IZOCRYSTAL

Aditiv hidroizolues betoni, në formë pluhuri, që shtohet gjatë përgatitjes së betonit, duke krijuar përbërje të patretshme, kristalore.

KARAKTERISTIKAT

Aditiv hidroizolues betoni, në formë pluhuri, që shtohet gjatë përgatitjes së betonit, duke krijuar përbërje të patretshme, kristalore. Përmirëson papërshkueshmërinë nga uji, pa ndikuar përshkueshmërinë e avujve të betonit. Mbetet aktiv gjatë gjithë kohës dhe pranon gjithashtu trysni pozitive dhe negative hidrostetike. I përshtatshëm për izolimin e themeleve, bodrumeve, rezervuarëve, gropave septike, pishinave etj. Klasifikohet me shenjën CE si përzjerje betoni, rezistente ndaj ujit, sipas standardit EN 934 - 2:T9.

FUSHA E PËRDORIMIT

IZOCRYSTAL është produkt i nevojshëm për të prodhuar beton me veti mekanike të lartë, beton që nuk suvatohet (për qëllime dekorative), beton të përshtatshëm për t'u hedhur me pompë etj. Gjithashtu përdoret për ndërtimin e elementeve prej betoni që kanë prezencë uji të vazhdueshme ose të përkohshme si themelet, bodrumet, rezervuarët, kanalet, tunelet, impiantet për pastrimin e ujërave të zeza, pishinat etj.

MËNYRA E PËRDORIMIT

Izocrystal mund të shtohet:

Në fazat fillestare të përzjerjes gjatë prodhimit të betonit. Në betonin e gatshëm pak kohë para përdorimit të tij. Në këtë rast duhet që betoni- era të rrotullohet për 4 - 5 minuta që të kemi shpërndarje uniforme të IZOCRYSTAL në masën e betonit.

DOZIMI

0.5 - 1 Kg për 100 Kg çimento

PAKETIMI

Produkti është i ambalazhuar në thesë 20 Kg.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit në vënde të mbrojtura nga ngrica.

